

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

MANJOLA BRAHAJ

PROZA E PASHKUT MES MODERNES DHE EKPERIMENTALES

Në këtë punim do të trajtojmë procesin dhe ecurinë e punës kërkimore shkencore të temës së Doktoraturës, e cila i përket procesit tonë të Shkollës Doktorale. Teza jonë e Doktoraturës është *“Proza e Pashkut mes modernes dhe ekperimentales”* ndaj në këtë kumtesë do të veçojmë, duke mos u zgjatur tërësisht, kapituj dhe nënkapitujt e realizuar deri tani, kërkimet e bëra dhe përfundimet e deritanishme si rezultate shkencore.

a) RECEPTIMI

Vepra letrare është një krijesë, e duke qenë e tillë ajo ka jetën dhe rrugën e saj, nga krijimi e deri tek dëshmia e ekzistencës së saj, që është leximi. Rëndësia e lexuesit në procesin e komunikimit letrar ka qenë i ditur kohë më përpara, por me Jakobsonin (e skemën e tij të komunikimit) e tutje ai filloi të konsiderohej ndër elementët vitalë të funksionimit të letërsisë, sepse gjuhësia moderne ndikoi në mënyrë direkte në *teoritë letrare moderne*¹.

Eko flet për lexues model, i cili sipas tij e rikrijon veprën hap pas hapi ashtu siç ka bërë *autori model*.² Wolfgang Iser i kushton rëndësi procesit të leximit, ndër të tjera, duke shtruar pyetjen: *“Si dhe në çfarë kushtesh, ka kuptim një tekst për lexuesin?”*³ e, gjithashtu, duke afruar me Eko-n, kur flet për lexues “të nënkuptuar” apo “rol” siç e quan ai. Kurse Gadamer shton dhe një faktor të rëndësishëm që fenomenologjia e kishte anashkaluar, kohën, ose më saktë distancën kohore që krijohet mes objektit që interpretohet dhe interpretimit në vetvete, duke mos e konsideruar si barrierë këtë fakt, por *si tipar produktiv të marrëdhënies së tyre*.⁴ Gjë të cilën do ta përforcojë dhe do t’i kushtojë rëndësi më shumë Hans - Robert Jauss me teorinë e tij për *horizontin e pritjes* apo të dialogut mes së tashmes dhe së shkuarës.

Me pak fjalë kthehet vëmendja ndaj faktorit lexues, dhe jo vetëm kthehet, por edhe i jepet rëndësi e madhe, duke ofruar një seri këndvështrimesh dhe teorish.

E prapë vepra ka jetën e saj, pavarësisht se shpesh faktori lexues, sidomos kur flasim për lexuesin e kualifikuar (studiues, kritik) ka rol decisiv në të.

Horizontet e pritjeve nuk mund të parashikohen e nuk janë kurrë, as nuk mund të jenë të njëjta, qoftë dhe për vepra të njëjta. Pasi faktorët vend dhe kohë luajnë një rol të dorës së parë në mënyrën se si pritët një vepër, sidomos ky i dyti

¹ A. Jeferson & D. Roby, *Teoria letrare moderne*, Albas, Tiranë, 2006.

² M. P. Pozzato, *Semiotika e tekstit, lexuesi model*, përkth. Dh. Shehri, Bot. Shblu, Tiranë, 2005.

³ A. Jeferson & D. Roby, *Teoria letrare moderne*, Albas, Tiranë, 2006, f. 189.

⁴ Po aty, f. 192.

është i çuditshëm dhe vendimtar në kuptimin, pritjen apo refuzimin e një veprë. Një kohë e pret një vepër, një kohë tjetër e refuzon atë, një kohë e përdor, një tjetër e keqpërdor.

Historia e letërsisë botërore, por edhe ajo shqiptare na kanë dhënë shembuj plot për një dukuri të tillë. Shekspirin nuk e mirëpriti koha e tij, ndërkohë që ka dekada që e çmon gjithë bota, Danten për më tepër e dëbuan dhe e syrgjynosën, ndërkohë, sot për sot mbetet ndër gjenitë e letërsisë botërore. Në letërsinë shqipe kemi rastin e Fishtës që e pret koha e viteve 30-40 derisa imponuar nga jashtë, i shkëputet kanali i komunikimit me lexuesin, për t'u rikthyer pas 50 vitesh në një kohë tjetër, që e pret atë në një mënyrë tjetër. E kështu plot raste të tjera, duke krijuar e surprizuar me mënyrën se si jetojnë veprat, duke krijuar dofarë *paradoksesh të receptimit*⁵.

Edhe vepra e Pashkut ka pasur një histori të receptimit të veçantë, krijimtaria e tij e shkruar dhe e botuar në 1957 - 1976, arrin të ketë lexuesit e saj në Kosovë, aty ku edhe botohet për herë të parë, ndërkohë në shtetin shqiptar, çka i përket Republikës së Shqipërisë, për shkak të ekzistencës së realizmit socialist, duke qenë se nuk ishte një krijimtari e atij lloji, as nuk bëhej fjalë të pranohej, apo të kishte komunikim me lexuesin apo studiuesin shqiptar të asaj kohe. Pavarësisht rënies së pushtetit komunist romanin e Pashkut dhe tregimet e tij vonë²⁰⁰⁷ do t'i gjejmë me titullin "Kulla"⁶ tek shtëpia botuese Naim Frashëri, në 2002 "Oh-un" tek shtëpia botuese Camaj - Pipa dhe asgjë tjetër. Pavarësisht hapjes së kufijve dhe komunikimit, i cili tash është shumë më i lehtë dhe më i shpeshtë mes trojeve shqiptare, në çfarëdo aspekti, Anton Pashku në Shqipëri, vazhdon të jetë i panjohur për lexuesin e thjeshtë, dhe i keq njohur për lexuesin e kualifikuar, pasi i vetmi tregim që interpretohet, komentohet dhe ofrohet në tekstet shkollore shqiptare është tregimi "Kulla", kurse tani për tani as nuk përmendet si i tillë.

Ndërkohë me studimin e veprës së Pashkut, si fillim, u morën me tregimet e tij, gjejmë emra si; Hasan Mekuli⁷, i cili bën një ndër vlerësimet dhe interpretimet ndoshta më të rëndësishme dhe që iu kanë referuar edhe studiuesit e tjerë. Këtë proces e vazhdoi Vehap Shita⁸ku edhe ky që me tregimet e para dhe vazhdimësinë e këtij shkrimtari e ndoqi me kureshti, por edhe duke e kuptuar vlerën e tij si tregimtar, duke bërë kështu edhe një vlerësim objektiv dhe të mundshëm për referime të mëtejshme. Më vonë më 1966 me këtë prozë merret studiuesi Ali D.

⁵ Paradokset e receptimit kemi vendosur t'i emërtojmë dukurinë e pritjes dhe receptimit nga ana e lexuesit të një veprë apo autori të caktuar, e cila siç e thamë më sipër ndryshon duke kaluar nga koha në kohë, nga një lexues tek tjetri.

⁶ A. Pashku, *Kulla*, Naim Frashëri, Tiranë, 2007.

⁷ H. Mekuli, *Gjurmim serioz i trajtave të reja*, 1962, në Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996, f. 473-484. (Botuar për herë të parë më 1962).

⁸ V. Shita, *Hulumtimet psikike në prozën e Anton Pashkut*, Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996. (Botuar për herë të parë në 1970).

Jasiqi⁹, i cili mundohet të kapë aspektin meditativ dhe simbolik të tregimeve, duke nxjerrë në pah angazhimin e kësaj proze.

Për të vazhduar pastaj me një vështrim më shumë tematik, të Samedin Mumxhiut¹⁰ më 1967, i cili duke bërë të ditur qëndrimin e tij subjektiv arrin edhe të spikasë faktin se proza e Pashkut është një prozë e përpunuar gati shkencërisht, pra i mëshohet aspektit ndërtimor dhe krijues të prozës, duke u ndalë tek tregime të posaçme që për mendimin e tij nuk janë përfunduar si të tilla.

Më pas do vijë edhe Jusuf Buxhovi¹¹ më 1973, po në këtë vit shkruan edhe kritiku Mensur Raifi¹², i cili nxjerr në pah elementët tekstorë të ndërtimit të prozës së Pashkut, ndërsa në vitin 1975 kemi ndoshta kritikën më të ashpër që i është bërë kësaj proze, kësaj radhe nga studiuesi Rexhep Qosja¹³ duke kritikuar për tematikën, mënyrën e realizimit të personazheve, mungesën e ideve, të gjitha këto në një ndër kritikë të zgjeruara të Qoses, i cili arrin në përfundimin se Pashku e trajton njeriun njëanshmërisht dhe bën eksperimente me të sit ë ishte një mi eksperimental. Në shkrimet e tyre drejtpërdrejtë e disa herë edhe tërthorazi, vetvetiu do të kundërshtohen këto teza na autorë të tjerë që janë marrë me veprën e Pashkut¹⁴ studiues si Sabri Hamiti, i cili në kohë të ndryshme vazhdimisht ka qenë një ndër kritikët që është marrë me tërësisht veprën e këtij autori duke bërë analiza dhe interpretime të thelluara dhe me metodat tekstuale ka sjellë objektivitet dhe ka bërë të mundur që këtë autor ta kuptojnë edhe t'i referohen shumë edhe kritikë të tjerë pasues të tij.

Në këtë vrazhdë të studimeve për këtë autor duhet të përmendim edhe Shefqet Riza¹⁵ e R. M. Shala¹⁶, i pari më 1979, duke u ndalur pos tregimeve edhe romanit Oh, që tashmë ishte botuar, i cili edhe më vonë do t'i kushtojë një vepër studimore veprës së këtij autori, duke na dhënë më metoda të semiotikës dhe ato krahasimtare studimin “Moderna pashkiane”.

Dihet që këtë panoramë studimesh letrare për këtë autor e gjemë më shumë në Kosovë shumë më shumë se në Shqipëri, pasi siç duket qartë tek kjo e fundit ka ndikuar shumë shkëputja dhe moskontakti fillestar me veprën e Pashkut, dhe kjo lloj krijimtarije, duke mos pasur paraardhës as pasardhës në llojin e saj në letërsinë shqipe, ky fakt ka ndikuar që ajo të jetë e panjohur dhe shpesh të refuzohet studimi i saj, por gjithsesi, duke mbetur një vepër e receptueshme vetëm në suazat

⁹ A. D. Jasiqi, *Ngjarja e vërtetë dhe meditimi artistik*, Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996, f. 544.

¹⁰ S. Mumxhiu, *Pashku: Jeta e vdekja dhe dashunia*, Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996, f. 507.

¹¹ J. Buxhovi, *Kërkim i përhershëm*, Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996, f. 568.

¹² M. Raifi, *Kërkim i përhershëm i figuracionit*, po aty, f. 524.

¹³ R. Qosja, *Shkrimtarë dhe periudha*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1975, f. 369-398.

¹⁴ S. Hamiti, *Triumfi i inteligjencës*, Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë 1996, f. 572.

¹⁵ Sh. Riza, *Vlera estetike e tregimeve të Anton Pashkut*, Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996, f. 536.

¹⁶ R. M. Shala, *Vetëdija mitike e qenësisë dhe e qëndresës*, Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996, f. 529.

akademike e universitare. Ndaj në Shqipëri mund të ndeshim studime letrare në nivel artikulli dhe kohët e fundit vihen re edhe interesime për studime dhe mbrojtje të temave të masterit apo doktoraturës për këtë autor, por botime konkrete që të komunikojnë me lexuesin dhe rrethin e studiuesve jo. Kështu pashkianët e Shqipërisë janë; Haki Baçi¹⁷, P. Palushi¹⁸, L. Topçiu¹⁹, N. Lushaj²⁰, A. Aliu²¹, Gj. Shkurtaj²² etj., të cilët janë ndalë në aspekte të ndryshme të veprës, gjuhësore, poetike dhe ndërtimore, duke nxjerrë në pah elementë dhe tipare konkrete të kësaj krijimtari, por sidomos, duke e vlerësuar në llojin e saj.

Pra, proza e Pashkut ka njohur në fillimet e saj, qoftë ngritjen në pedestal, qoftë vërejtjet konkrete, qoftë dhe konstatimet e pa argumentuara, duke u quajtur hermetike, në disa raste të tjera neutrale, për shkak se kritika nuk ishte mësuar me një mënyrë të tillë të shkruari dhe raste të tjera formale, duke parë realizimin krejt joklasik e jorealit që ndërton Pashku me Oh-in, por edhe rëndësinë prej shkencëtari që i kushton formës artistike, qoftë të tregimeve, qoftë të romanit. Dhe siç u pa është shkruar dhe folur shumë, për këtë prozë që mbetet edhe sot e kësaj dite për studiuesit dhe jo për lexuesit e thjeshtë, duke qenë se është një lloj letërsie e tejkaluar, por që ka vlerat e saj për kohën dhe kushtet kur u shkrua, kushte të cilat ndikuan në mënyrën e saj të paraqitjes dhe sidomos në prirjen e saj angazhuese për kombin dhe shoqërinë.

Kjo vepër sipas studimeve tona i ka kaluar shumë lloje të receptimit siç u pa, të cilat keq apo mirë i kanë shërbyer leximit dhe të qenit në kontakt me studiuesit kohë pas kohe dhe mbetet një model i një letërsie të veçantë në letërsinë shqipe.

b) MODERNIZMI I VEPRËS SË PASHKUT

Në princip kur kemi të bëjmë me letërsinë moderne natyrisht që duhet të shohim dhe t'u referohemi edhe marrëdhëniet që kjo lloj letërsie ka me traditën, sepse është ndër elementët thelbësorë që e bën atë të dallueshme. Dhe pikërisht në këtë pikë, në varësi ndaj qëndrimit që kanë mbajtur letërsitë e ndryshme të kohëve të ndryshme janë diferencuar apo përbashkuar me njëra - tjetrën. Modernizmi²³ në letërsinë ashtu si edhe të gjitha drejtimit e tjera apo rrymat letrare erdhi dhe u soll më saktë si mënyrë e shkrimit dhe realizimit të veprave vetëm nëpërmjet një autori

¹⁷ H. Baçi, *Anton Pashku*, Mësuesi, e shtunë, 16 janar 1993, f. 4.

¹⁸ P. Palushi, *Proza sugjestionuese e Anton Pashkut; Harmonia stilistike në tregimin Floçka*, Albania, 13 dhjetor 2000, f. 10.

¹⁹ L. Topçiu, *Romani "Oh" model dhe stil*, Flaka, 28 prill-2 maj 2001, f. 16.

²⁰ N. Lushaj, *Modernizmi i romanit "Oh" të Anton Pashkut*, Mher Licht, Nr. 23, prill 2004, f. 325-333.

²¹ A. Aliu, *Krijuesi dhe dhuntia e artit të Anton Pashkut*; Konferencë shkencore për krijimtarinë e shkrimtarit nga Kosova, Ndryshe, 19 dhjetor 2006, f. 20.

²² Gj. Shkurtaj, *Vlera dhe prurje gjuhësore në ligjërimin e Anton Pashkut*, Koha Jonë, 16 dhjetor 2006, f. 14.

²³ I referohemi letërsisë së këtij drejtimi, dhe në rastet kur të tekst do gjendet termi letërsi moderne, do i referohemi pikërisht kësaj letërsie, jo moderne si e re apo novatore, por konkretisht letërsisë së modernizmit.

të vetëm dhe ky autor është Anton Pashku. Pashku dhe letërsia e tij në frymën e modernizmit nuk vjen vetvetiu, as në një formë të pandërgjegjshme nga ana e autorit, ai shkruan një prozë të pjekur dhe të mirëmenduar, ndoshta do të mund ta klasifikonim në tipin e shkrimtarëve pedantë dhe *sikur përmbush profetizimin e prozatorit francez, Gystav Floberi*²⁴ që i kthehet dhe i rikthehet frazës së tij, e shkruan dhe rishkruan, duke e bërë atë frut të një logjike të kulluar, por edhe të një inteligjencie të hollë. Këtë gjë na e vërtetojnë edhe njohjet e tij të pafundme me letërsinë botërore moderne, me rrymat dhe drejtimet që përfshinin Evropën dhe me emrat e shkrimtarëve dhe studiuesve të cilëve ai iu referohet²⁵. Kjo ka ardhur si rezultat i të qenit në një rreth të hapur ndaj ndryshimeve, njohjeve dhe botimeve më të reja në letërsinë dhe teoritë letrare e kritike moderne, çka e dëshmojnë të gjitha shkrimet e këtij grupi të studentëve që formuan dhe e mbajtën gjallë revistën *“Le të rrjedhë lumi”*²⁶, ku flitet për teori dhe metoda studimi, për kritikën moderne dhe atë tradicionale, për çështjen e ndikimit, për nevojën e një qasje të re ndaj tekstit të ri, për gjuhën poetike dhe atë të zakonshme, për letërsinë masive, çështjen e formës dhe të përmbajtjes, çka tregon për komunikimin e Pashkut dhe të brezit të ri të studiuesve dhe krijuesve në Kosovë me letërsinë modern, por edhe me kritikën moderne.

Por nëse letërsia moderne, sidomos ajo franceze, ishte ajo që tentoi të ndryshonte, të eksperimentonte me të gjithë elementët strukturorë të një veprë, përfshirë këtu, personazhet, procedimet kohore, narracionin, subjektin, fabulën etj., siç shpreheshë Jean Ricardou, romani nuk duhej të ishte **“shkrimi i një aventure, por aventura e një shkrimi”**. Shembuj të tillë kujtojmë këtu ndjekësit e të ashtuquajturit *Romani i ri*, që ishin thellësisht eksperimentalë, gati - gati krijues në bazë recetash: Jean Ricardou, Nathalie Sarraute **“Portreti i një të panjohuri”**, Claude Simon **“Litari i fortë”**, Robert Pinget **“Gomat”**, Marguerite Duras **“Dashnori”**, Samuel Beckett **“Molly”** etj.

Pra, arti modern është art *ekperimental, formalisht kompleks, eliptik*²⁷, duke mundësuar kështu procedime të papara më parë në periudhat e tjera, që këndeje nëse mund të flasim për një roman modern dhe eksperimental në letërsinë shqipe, por edhe të ndërlikuar në mënyrën se si ai strukturohet, se si i ngërthen dhe përzien zhanret letrare, se si e realizon narracionin²⁸ atëherë është, padyshim, romani “Oh” i Anton Pashkut.

²⁴ R. Qosja, *Mbi tregimet e Anton Pashkut*, “Në mbretërinë poetike”, Shpresa, Prishtinë, 2002, f. 77.

²⁵ A. Pashku, *Le të rrjedhë lumi*, DITURIA (revistë shkencore e studentëve të Kosovës), nr. 4-1972, f. 24-28.

²⁶ *Le të rrjedhë lumi*, DITURIA (revistë shkencore e studentëve të Kosovës), nr.-4-1972.

²⁷ P. Childs, *Modernism (the new critical idiom)*, Routledge, Taylor & Francis Group, London and New York, 2000, f. 2-25.

²⁸ Për më shumë dhe për një mënyrë tjetër të vështrimit të narracionit në romanin “Oh” shih: N. Krasniqi: *Autori në letërsi*, AKID, Prishtinë, 2009, f. 199-232.

Duke iu referuar mënyrës së shkruarit dhe sidomos anës eksperimentale të veprave të Pashkut Elsie shprehet: “*Tregimet, romanet dhe pjesë teatrore eksperimentale, që dëshmojnë afri me veprat e Xhorxh Oruellit, Franc Kafkës dhe Robert Musilit, janë në vetvete studime të holla e mjeshtërore të njeriut, ndonëse kërkojnë durim nga njeriu i thjeshtë.*”²⁹ Këtë gjë e vëmë re edhe në mendimet e Andi Bejtjes për Pashkun kur shprehet se “*Proza e Anton Pashkut të kujton prozën e Joyce-it dhe të Proust-it, nganjëherë ai është më i afërt me Kafka-an*”³⁰

E të gjitha këto përafri dhe ngjashmëri na shfaqen vetëm nëse i referohemi punës artistike të Pashkut, tekstit të tij artistik, me frazat e gjata që kalojnë pothuaj dy faqe na kujtojnë domosdoshmërisht prozën e Prustit, me analizën psikologjike dhe dhënien e përroit të ndërgjegjes, ai vërtet mundtë quhet një *Xhojs i letërsisë shqipe*³¹ edhe shumësia dhe rëndësia e detajeve sikur të kujton dhe i përmbahet mendimit të prozatores së njohur angleze, *Virxhinia Woolf*³², por pavarësisht të gjitha këtyre përafri dhe ndikimeve Pashku me zërin e tij na prezanton origjinalitet dhe një krijimtari unike në letërsinë shqipe, sepse askush nuk i ka shpëtuar grackës së ndikimit ose thënë më ndryshe të gjithë marrim nga njëri - tjetri, po e gjitha kjo ndodh në mënyrë të pavetëdijshme, sepse përjetimet dhe përvojat tona qoftë leximore, qoftë jetësore shtresëzohen si palimpsestet dhe shfaqen aty kur ne krijojmë pa na pyetur ne.

Ndaj si përfundim, vepra e këtij shkrimtari, me të gjitha mënyrat e saj komplekse të trajtimit dhe me gjithë tiparet e saj që afrojnë, siç e thamë më sipër, më shumë se më asnjë lloj të letërsisë, me modernizmin, mbetet një krijimtari që meriton vëmendjen dhe vlerësimin e kritikës dhe të lexuesit njëkohësisht sepse kjo vepër plotëson një hallkë të munguar më parë në historinë e letërsisë sonë dhe me praninë e saj ajo sikur plotëson dhe i jep më shumë ngjyra e vlera mozaikut të përgjithshëm.

BIBLIOGRAFIA

- A. Aliu, *Krijuesi dhe dhuntia e artit të Anton Pashkut*; Konferencë shkencore për krijimtarinë e shkrimtarit nga Kosova, Ndryshe, 19 dhjetor 2006, f. 20.
 A. Jefferson & D. Roby, *Teoria Letrare Moderne*, Albas, Tiranë, 2006.
 A. Vinca, *Postmodernizmi dhe teoria e intertekstualitetit*, Seminari XX/ 2, Prishtinë, 2001.
Bibla, Besëlidhja e vjetër dhe Besëlidhja e re, përkth: Dom Simon Filipaj, Konferenca Ipeshkvore e Shqipërisë, Tiranë 2011.
 A. D. Jasiqi, *Ngjarja e vërtetë dhe meditim artistik*, Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996, f. 544.
 A. N. Berisha, *Në mbretërinë poetike*, Shpresa, Prishtinë, 2002.
 A. Bejtja, *Pashku - planeti tjetër*, Mher Licht, nr. 5, 1998, f. 28.
 A. Pashku, *Oh*, Botim i 4, Rilindja, Prishtinë, 1990.
 G. Genet, *Figurat*, Rilindja, Prishtinë, 1985.

²⁹ R. Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Pejë - Tiranë, 1997, f. 443-444.

³⁰ A. Bejtja, *Pashku - planeti tjetër*, Mher Licht, nr. 5, 1998, f. 28.

³¹ M. Ramadani, *Xhojsi i letërsisë shqiptare*, Albania, 10 nëntor 2001, f. 10.

³² R. Qosja, *Mbi tregimet e Anton Pashkut*, “Në mbretërinë poetike”, Shpresa, Prishtinë, 2002, f. 78.

Proza e Pashkut mes modernes dhe ekperimentales

- H. Baçi, *Anton Pashku*, Mësuesi, e shtunë, 16 janar 1993, f. 4.
- H. Mekuli, *Gjurmim serioz i trajtave të reja*, 1962, në Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996, f. 473 - 484.
- J. Buxhovi, *Kërkim i përhershëm*, Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996, f. 568.
- K. M. Shala, *Shekulli i letërsisë shqipe*, Buzuku, Prishtinë, 2006.
- M. P. Pozzato, *Semiotika e tekstit*, përkth. Dh. Shehri, Bot. Shblu, Tiranë, 2005.
- M. Raifi, *Kërkim i përhershëm i figuracionit*, Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996, f. 524.
- M. Raifi, *Kulla solidare e malësisë*, Albania, 10 nëntor 2001, f. 10.
- M. Ramadani, *Xhojsi i letërsisë shqiptare*, Albania, 10 nëntor 2001, f. 10.
- N. Krasniqi, *Libri i Pashkut (Romani Oh- interpretim letrar)*, Buzuku, Prishtinë, 2005.
- N. Lushaj, *Modernizmi i romanit "Oh" të Anton Pashkut*, Mher Licht, Nr. 23, prill 2004, f. 325-333.
- P. Childs, *Modernism (the new critical idiom)*, Routledge, Taylor & Francis Group, London and New York, 2000.
- P. Gros - Natalie, *Poetika e intertekstualitetit*, përkth. Urim Nerguti, Parnas, Prishtinë, 2011.
- P. Palushi, *Proza sugjestionuese e Anton Pashkut; Harmonia stilistike në tregimin Floçka*, Albania, 13 dhjetor 2000, f. 10.
- R. Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Pejë- Tiranë, 1997, f. 443 - 444.
- R. Qosja, *Shkrimtarë dhe periudha*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1975, f. 369 - 398.
- R. M. Shala, *Vetëdija mitike e qenësisë dhe e qëndresës*, Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996, f. 529.
- R. M. Shala, *"Ex libris" moderna pashkiane*, Papyrus, Prishtinë, 2000.
- S. Mumxhiu, *Pashku: Jeta e vdekja dhe dashunijs*, Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996, f. 507.
- S. Hamiti, *Tregimet fantastike të Anton Pashkut*, Albania, 3 korrik 2003, f. 10.
- S. Hamiti, *Triumf i inteligjencës*, Jeta e Re, nr.4, Prishtinë, 1996, f. 572.
- Sh. Riza, *Vlera estetike e tregimeve të Anton Pashkut*, Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996, f. 536.
- Gj. Shkurtaj, *Vlera dhe prurje gjuhësore në ligjërimin e Anton Pashkut*, Koha Jonë, 16 dhjetor 2006, f. 14.
- U. Eko, *Gjashtë udhëtimet e tregimtarisë*, DITURIA, Tiranë, 2007.
- V. Zhmeqaj, *Tipat e intertekstualitetit dhe funksioni i tyre*, në Jeta e Re, nr.1, Prishtinë, 2012, f. 282.
- V. Shita, *Hulumtimet psikike në prozën e Anton Pashkut*, Jeta e Re, nr. 4, Prishtinë, 1996, f. 491.

